



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**Nr. regjistri 1/2018(JR)
Datë 27.03.2018Nr. vendimi 1/2018 (JR)
Datë 11.06.2018**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues i Trupit Gjykses
Luan Daci	Relator i Çështjes
Albana Shtylla	Gjyqtare
Ardian Hajdari	Gjyqtar
Ina Rama	Gjyqtare

monitoruar dhe mbikëqyrur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar Branko Hrvatin, asistuar nga Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, në Tiranë, sot më datë 11.06.2018, ditë e hënë, ora 13:00, në seancë gjyqësore publike për shpalljen e vendimit që i përket çështjes së Juridiksionit të Rivlerësimit në lidhje me gjykimin e ankimit për çështjen nr. 1/2018 (JR), datë 27.03.2018, me të dhënat e mëposhtme –

Ankues: Komisioneri Publik Florian Ballhysa
Subjekti i rivlerësimit: Z. Adriatik Llalla, Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, me përfaqësues Avokatin Sokol Hazizaj, me nr. licence 1188 dhe NIPT K72111028T
Objekti: Prishjen e vendimit nr. 2, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Adriatik Llalla
Baza ligjore: Nenet F/3 dhe G të Aneksit të Kushtetutës, nenet 14 dhe 57 të ligjit nr. 84/21016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

– pasi dëgjoi Komisionerin Publik Florian Ballhysa i cili kërkoi “Prishjen e vendimit të Komisionit”, Avokatin Sokol Hazizaj i cili kërkoi “Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit”, si edhe shqyrtoi aktet e dosjes, Trupi Gjykses, pas raportit dhe rekomandimit të Relatorit të Çështjes

VËREN:

1. Në datën 27.03.2018, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (Kolegji i Apelimit) është paraqitur ankimi i Komisionerit Publik, nëpërmjet shkresës nr. 6 Prot., datë 23.03.2018, kundër vendimit nr. 2, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (Komisioni).

2. Në seancën gjyqësore publike, të caktuar në datën 16.05.2018, Trupi Gjykses, pasi u konsultua lidhur me situatën procedurale të legjitimitit procedural të subjektit të rivlerësimit, vendosi t'i kërkojë përfaqësuesit, Avokatit Sokol Hazizaj, me nr. licence 1188 dhe NIPT K72111028T, plotësimin e prokurës me nr. 1162 Rep., nr. 286 Kol., të datës 10.04.2018, duke u shprehur në mënyrë të posaçme vullneti i të përfaqësuarit. Kolegji vendosi përsëritjen e njoftimit të ankimit, së bashku me njoftimin e vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit, si dhe shtyrjen e seancës gjyqësore për t'i lënë në dispozicion kohën e nevojshme subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij për të plotësuar aktin e përfaqësimit.

3. Në seancën gjyqësore publike, datë 31.05.2018, subjekti i rivlerësimit u përfaqësua rregullisht nga Avokati Sokol Hazizaj, nëpërmjet prokurës së posaçme nr. 8263(A), datë 28.05.2018, e nënshkruar para noterit turk Eyüp Sabri Erdoğan dhe e legalizuar sipas Konventës së Hagës së 5 tetorit 1961 (*Apostille*).

4. Në seancën gjyqësore publike datë 31.05.2018, pasi dëgjoi parashtrimet e Komisionerit Publik rreth ankimit të paraqitur, të cilat u depozituan edhe shkresërisht, si dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet Avokatit Sokol Hazizaj, të cilat gjithashtu u depozituan edhe shkresërisht, me kërkesën e këtij të fundit pranoi administrimin e provave të reja, specifikisht: i) shkresë e prokurorit Adriatik Llalla, datë 13.10.2008, për dorëheqje nga detyra e prokurorit, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm; dhe ii) urdhër nr. 285, datë 30.10.2008, "Për largim nga detyra" të zotit Adriatik Llalla, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Në seancën gjyqësore publike datë 31.05.2018, Trupi Gjykses i dha fund hetimit gjyqësor duke ftuar palët për të paraqitur me shkrim pretendimet përfundimtare po në seancë gjyqësore publike, të caktuar në datën 6.06.2018.

6. Në seancën gjyqësore publike datë 6.06.2018, Trupi Gjykses mori në shqyrtim pretendimet përfundimtare të palëve të paraqitura shkresërisht dhe të relatuara verbalisht.

Rrethanat e faktit

7. Pas hedhjes së shortit për subjektet e rivlerësimit me përparësi në kohë, datë 6.11.2017, Komisioni ka filluar kryesisht hetimin administrativ në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Llalla me detyrë Prokuror i Përgjithshëm, duke nisur me shqyrtimin sipas ligjit të kontrollit të tri kriterëve: i) kontrollit të pasurisë; ii) kontrollit të figurës; iii) kontrollit të aftësive profesionale.

8. Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në datën 7.12.2012, pas dhënies së pëlqimit nga Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 49/2012 të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 19.12.2012. Këtë detyrë subjekti i rivlerësimit e ka ushtruar deri në datën 18.12.2017. Në bazë të vendimit të Kuvendit nr. 115/2017 "Për caktimin e prokurorit që do të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm", publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017, është caktuar prokurori që do të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm.

9. Procesi i rivlerësimit nga ana e Komisionit ka vazhduar edhe pas mbarimit të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak se gëzonte statusin e magjistratit dhe të drejtën e emërimit në nivel apeli.

10. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit me shkresën “informuese” datë 24.01.2018, drejtuar Komisionit – dhe në vëmendje të Kryetares së Komisionit – bën me dije se, duke qenë se mandati si Prokuror i Përgjithshëm ka përfunduar në datë 18.12.2018, ai nuk konsiderohet më subjekt rivlerësi, aq më tepër subjekt prioritar për t’iu nënshtruar rivlerësimit sipas ligjit të mësipërm (ligji nr. 84/2016).

11. Me anë të shkresës “kthim përgjigje”, datë 1.02.2018, Kryetarja e Komisionit orienton subjektin e rivlerësimit se procesi i rivlerësimit konsiderohet i nisur që nga momenti i plotësimit të deklaratave të kontrollit të pasurisë, të figurës dhe të vetëvlerësimit profesional, si dhe depozitimit të tyre në institucionet përkatëse, sipas ligjit nr. 84/2016. Duke vijuar, Kryetarja e Komisionit shprehet se përfundimi i mandatit si Prokuror i Përgjithshëm nuk lidhet me përfundimin e statusit si magjistrat apo si person që ka ushtruar atë funksion, çka tregon se subjekti i rivlerësimit vazhdon të gëzojë statusin dhe, me përfundimin e mandatit si Prokuror i Përgjithshëm, gëzon të drejtën, me kërkesë, për të qenë ende pjesë e sistemit të drejtësisë, në pozicionin e gjyqtarit në gjykatën e apelit. Në këto kushte, Kryetarja e Komisionit arrin në përfundimin se ndërprerja e procedurave të rivlerësimit nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mund të bëhet vetëm nëse vërtetohen kushtet e parashikuara nga neni G i Aneksit të Kushtetutës.

12. Në vijim të komunikimeve, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 10.02.2018, drejtuar Presidentit të Republikës, të protokolluar pranë këtij institucioni në datën 12.02.2018, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje në të cilën shprehimisht bën me dije se nga data 7.12.2012 deri në datën 18.12.2017 ka ushtruar funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, i referohet nenit 61 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikimit se me mbarimin e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm ai ka të drejtë që të caktohet në një pozicion apeli dhe, në përfundim, në aplikim të nenit 56 të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH dhe vendimit nr. 79, viti 2017 të Gjykatës Kushtetuese të RSH në të cilin parashikohet e drejta për të hequr dorë në çdo kohë nga funksioni i magjistratit deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, paraqet dorëheqjen nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që i njej ligji për t’u emëruar në një pozicion në nivel apeli.

12.1. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimi në kërkesën për dorëheqje i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. 79, Trupi Gjykues konstaton se është një gabim material për shkak të përputhjes së kërkesës në përmbajtje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017.

13. Institucioni i Presidentit të Republikës, me anë të shkresës datë 12.02.2018, i ka komunikuar kërkesën për dorëheqje Kryetares së Komisionit dhe njëkohësisht i drejtohet edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si në vijim: “[...] bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje origjinale të kërkesës për dorëheqje të zotit Llalla nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që i njej ligji për t’u emëruar në një pozicion në Gjykatën e Apelit”.

14. Kërkesa e dorëheqjes drejtuar Presidentit të Republikës, i është komunikuar Kryetares së Komisionit edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës datë 12.02.2018, të protokolluar po në këtë datë, në të cilën i bën me dije se ka hequr dorë nga statusi i magjistratit dhe nga e drejta për t'u emëruar në një pozicion apeli dhe, për këtë arsye, lutet të zbatohet detyrimi ligjor dhe kushtetues duke marrë vendim për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, pasi paraprakisht në kërkesë i referohet vendimit nr. 78/2017, duke cituar: “Gjykata Kushtetuese ka vendosur në pikën nr. 43 të këtij vendimi: Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

Vendimi i Komisionit

15. Procesi i rivlerësimit para Komisionit është kryer me bazë dokumentesh.

16. Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim aktet e mësipërme, ka arsyetuar se dorëheqja është një e drejtë kushtetuese e njohur për subjektin e rivlerësimit.

17. Ndër të tjera, Komisioni arsyeton se, pavarësisht përfundimit të mandatit të tij kushtetues si Prokuror i Përgjithshëm, procesi i rivlerësimit ndaj tij ka vazhduar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sepse e vetmja mënyrë për ndërprerjen e këtij procesi, që parashikon legjislacioni shqiptar, është dorëheqja.

18. Gjithashtu, me paraqitjen e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 1737 Prot., datë 12.02.2018, Komisioni është vënë në dijeni të kërkesës për dorëheqje të subjektit të rivlerësimit “nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që i njih ligji për t'u caktuar në një pozicion apeli”, drejtuar Presidentit të Republikës.

19. Duke vijuar, Komisioni mban qëndrimin se ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, ai humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

20. Në përfundim të shqyrtimit dhe, pas arsyetimit sipas përmbledhjes më sipër, me anë të vendimit nr. 2, datë 16.02.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shprehimisht ka vendosur: i) Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Xhemal Llalla është ndërprerë. ii) Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Xhemal Llalla, Komisionerit Publik dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. iii) Kundër këtij vendim lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. iv) Ky vendim shpallet në datën 16.02.2018.

Ankimi i Komisionerit Publik

21. Komisioneri Publik, duke pretenduar se vendimi është i cenueshëm, me ankimin e paraqitur në datën 23.03.2018 ka kërkuar: “Prishjen e vendimit nr. 2, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Gjithashtu, Komisioneri Publik parashtron: “Jemi të mendimit se për sa kohë në këtë ankim ngrihen shkaqe që lidhen me interpretimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese do t’i shërbente unifikimit të procedurave në të ardhmen në trajtimin e situatave të ngjashme.

22. Në ankimin e paraqitur, Komisioneri Publik në mënyrë të përmbledhur kundërshton vendimin e Komisionit, duke parashtruar si shkaqe ankimore procedurën e zbatuar dhe vlerësimin në themel të çështjes.

23. Komisioneri Publik parashtron se – nisur nga arsytimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe nga aktet e administruara prej tij – nuk rezulton të jetë identifikuar dhe, për rrjedhojë, të jetë argumentuar zbatimi në rastin konkret i dispozitave kushtetuese dhe ligjore, organi kushtetues që është kompetent, si dhe procedurat për administrimin e kërkesës dhe vendimmarrjes përkatëse, në rastet e ushtrimit të së drejtës së dorëheqjes nga statusi i magjistratit, rrethana juridike këto, verifikimi i të cilave do të mundësonte urdhërimin nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të zbatimit të dispozitës së nenit G të Aneksit të Kushtetutës; dhe se, në mbështetje të argumentit të mësipërm, fillimisht do të duhej që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të analizonte momentin e emërimit të subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit dhe statusin që gëzonte në vijim me përfundimin e mandatit si Prokuror i Përgjithshëm, duke identifikuar kështu rregullimin ligjor përkatës.

24. Nuk rezulton, sipas Komisionerit Publik, që për subjektin konkret të rivlerësimit, z. Adriatik Llalla, pas zgjedhjes në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP-së, në tetor 2008, të ketë dalë një dekret i Presidentit të Republikës që ka disponuar për largimin e tij nga funksioni i prokurorit, për një nga shkaqet e parashikuara në ligj (eventualisht dorëheqje) dhe, në referencë të kësaj analize sistematike kushtetuese dhe ligjore, rezulton se për subjektin e rivlerësimit z. Adriatik Llalla ka dekret emërimi në funksionin e prokurorit nga Presidenti i Republikës, por nuk ka dekret për largim/shkarkim nga funksioni, kështu që subjekti i rivlerësimit z. Adriatik Llalla vijon të gëzojë statusin e magjistratit/prokurorit për shkak të funksionit të ushtruar para vitit 2008.

25. Mbarimi i mandatit të subjektit si Prokuror i Përgjithshëm, sipas Komisionerit Publik, nuk ndikon në vijimin e gëzimit të statusit si magjistrat/prokuror pasi, para përfundimit të mandatit të subjektit të rivlerësimit (18 dhjetor 2017), kishin hyrë në fuqi ndryshimet kushtetuese dhe ligji nr. 96/2916 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe dhënia e dorëheqjes nga detyra, në kuptim të nenit 56 të ligjit 84/2016, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, sjell si pasojë pushimin e procedurës së rivlerësimit dhe të drejtën e pagesës kalimtare të subjektit të rivlerësimit, sipas legjislacionit në fuqi për përfitime sociale. Aspektet procedurale të dorëheqjes janë detajuar në pikën 1 të nenit 56, ku përcaktohet organi të cilit i paraqitet kërkesa me shkrim, që është Presidenti i Republikës, dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Dhënia e

dorëheqjes nga detyra, në kuptim të ligjit 96/2016, gjen rregullim si në regjimin ligjor në situatë normaliteti, ashtu edhe në periudhën kalimtare deri në ngritjen e organeve të drejtësisë (Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë). Dispozitat e ligjit 96/2016, sipas përcaktimit të nenit 169, zbatohen menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit për sa u përket të drejtave dhe detyrave të magjistratit, ndaj dhe paraqet interes për çështjen trajtimi i rregullimeve ligjore në të dyja momentet (regjimi ligjor në normalitet dhe regjimi ligjor në periudhë kalimtare).

26. Në interpretim të nenit G të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjeve nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016, nuk është në kompetencë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të disponojë mbi deklarin e dorëheqjes nga statusi i magjistratit nga ana e subjekteve të rivlerësimit e, për më tepër, të ndërpresë procesin e rivlerësimit pa administruar aktin përkatës të organit kompetent ligjor, që shqyrton heqjen dorë nga statusi i magjistratit dhe merr vendimin përkatës. Vetëm pas administrimit të vendimit përkatës të organeve të lartpërmendura për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Adriatik Llalla, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të kalonte në vendimmarrje për të rregulluar pasojën e dorëheqjes, që në rastin konkret do të jetë dorëheqja nga procesi i rivlerësimit.

27. Kompetencën e emërimit, rrjedhimisht edhe atë të ndalimit të emërimit për magjistratët, Kushtetuta ua njuh dy organeve të ngritura për këtë qëllim, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nisur nga argumenti i trajtuar më lart, mendojmë se pjesë e vendimmarrjes së këtyre organeve kushtetuese që deklarojnë mbarimin e mandatit të magjistratit për efekt të nenit G të Kushtetutës do të duhej të ishte dhe ndalimi i parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni.

28. Për procedurën e shqyrtimit, Komisioneri Publik parashtron se Komisioni në rastin konkret ka vendosur vetëm mbi bazë dokumentesh, pa zhvilluar një seancë dëgjimore me praninë e subjekteve, që legjitimohen për t'u thirrur sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

29. Në seancën dëgjimore publike, datë 31.05.2017, Komisioneri Publik duke dhënë shpjegime rreth ankimit, ka parashtruar gjithashtu se: i) dorëheqja e magjistratit, në referencë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar; ii) pasoja e dytë që sjell dorëheqja e magjistratit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është ndalimi për 15 vjet që subjekti të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm; iii) z. Adriatik Llalla nuk i kishte mbaruar statusi i magjistratit në datë 16.02.2018, datë kur është dhënë vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pra gëzon ende statusin e magjistratit; iv) këtë status z. Adriatik Llalla e ka fituar duke qenë në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, ditën kur hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese dhe ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Por dorëheqja e magjistratit është dhe duhet të konsiderohet një institut ligjor, që gjen rregullim vetëm në dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

30. Sipas Komisionerit Publik, kërkesën për dorëheqje nga statusi i magjistratit, z. Adriatik Llalla duhet t'ia kishte drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ky i fundit të deklaronte me

vendim mbarimin e statusit të magjistratit dhe vetëm pasi të ndiqej kjo procedurë ligjore e parashikuar nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të ishte në kushtet, që referuar nenit G të Aneksit të Kushtetutës, të vendoste ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar. Është për t’u vënë në dukje, thekson Komisioneri Publik, që në tri raste të tjera të ngjashme, vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vepruar ndryshe, nga sa ka vepruar në rastin konkret me subjektin e rivlerësimit z. Adriatik Llalla. Ka nënvizuar ndërkohë se procedura e parashikuar nga dispozitat e neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes dhe procedura e administrimit të saj nuk duhet të vlerësohen vetëm në kornizën e formalizimit.

31. Komisioneri Publik parashtron se çfarë ndodh në qoftë se procesi i rivlerësimit në rastin konkret bazohet vetëm në një kërkesë të thjeshtë për dorëheqje, të paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet shërbimit postar. Gjithashtu parashtron se kush verifikon në qoftë se kjo kërkesë për dorëheqje shpreh ose jo vullnetin e lirë të magjistratit për dorëheqje; dhe se kush verifikon në qoftë se kjo kërkesë për dorëheqje është nënshkruar ose jo prej magjistratit. Këto elemente dhe situata ligjore mund dhe duhet të verifikohen vetëm nga organet përkatëse, Këshilli i Lartë i Prokurorisë/Prokurori i Përgjithshëm, ashtu siç parashikohet në ligjin nr. 96/2016.

32. Në referencë të analizës së mësipërme, Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet t’i lërë detyrë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të marrë edhe një herë në shqyrtim rrethanat ligjore dhe procedurale për të arritur në përfundimin nëse plotësohen apo jo kërkesat kushtetuese dhe ligjore për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj z. Adriatik Llalla, ekzistenca e të cilave mund të legjitimojë eventualisht kompetencën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të vendosur që të zbatohet dispozitën e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

33. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet Avokatit Sokol Hazizaj, në seancën dëgjimore publike datë 30.05.2018, pasi ka kundërshtuar në tërësi ankimin e paraqitur nga Komisioneri Publik, ka kërkuar: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 2, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

34. Sipas Avokatit Sokol Hazizaj: “Në vështrim të kohës dhe në vështrimin material, saktësoma disa momente, për të sqaruar se vendimi nr. 2, datë 16.02.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur të deklarojë ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Xhemal Llalla, është i drejtë, bazuar në ligj dhe i saktë si në vështrimin procedural dhe material gjithashtu. Arsye për të cilën, në cilësinë e subjektit të interesuar, jemi të detyruar të kundërshtojmë si tërësisht joligjor dhe jo të drejtë në përmbajtje ankimin prej Komisionerit Publik të vendimit të sipërcituar”.

35. Ai sqaron gjithashtu se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e ka konsideruar në vendimin e tij gjithë korrespondencën e sipërcituar të subjektit të rivlerësimit Adriatik Llalla, me anë të së cilës ka kërkuar dorëheqjen nga e drejta që i njeh ligji për t’u caktuar në një pozicion apeli,

parashikuar nga neni 61 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga vendimi nr. 78/2017 i Gjykatës Kushtetuese.

36. Nisur nga këto detyrime kushtetuese dhe ligjore, Avokati Hazizaj arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Adriatik Llalla ka ushtruar të gjithë të drejtën dhe detyrimin ligjor, të përshkruar më sipër, madje duke informuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për kërkesën për dorëheqje drejtuar Presidentit të Republikës, sipas parashikimit të nenit 56 të ligjit 84/2016.

37. Në përmbledhje të gjithë sa arsyeton, Avokati Hazizaj arrin në përfundimin se akti i dorëheqjes është një akt individual i njëanshëm, shprehje e vullnetit të personit, i cili, siç edhe parashihet në Kushtetutë dhe ligj, nuk ka nevojë për një konfirmim nga një autoritet tjetër, përveç parashikimit kushtetues dhe ligjor të sipërcituar, nuk mund të kufizohet në kohë për më tepër kur Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet në zbatim të saj apo vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese e ka parashikuar si të tillë.

38. Gjthashtu, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet Avokatit Sokol Hazizaj, Trupi Gjykses i Kolegjit të Apelit pranoi administrimin e provave të reja, specifikisht:

i) shkresë e prokurorit Adriatik Llalla, datë 13.10.2008, për dorëheqje nga detyra e prokurorit, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm; dhe ii) urdhër nr. 285, datë 30.10.2008, “Për largimin nga detyra të prokurorit, zotit Adriatik Lalla, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Ligji i zbatueshëm

39. “Konventa evropiane për të drejtat e njeriut”

39.1. Neni 6, “E drejta për një proces të rregullt”: Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

40. “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”

40.1. Neni 17: Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

40.2. Neni 148/a, pika 5: Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit.

40.3. Neni 148/c, pika 1: Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron kur: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 7-vjeçar; c) jep dorëheqjen; ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. 2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

41. Aneksi i Kushtetutës

41.1. Neni G, “Dorëheqja”: 1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

42. Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

42.1. Neni 56, “Dorëheqja”: 1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

43. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

43.1. Neni 65, “Dorëheqja”: 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

43.2. Neni 164, “Dispozitat kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”: 1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit, të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: [...] b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

44. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017, paragrafi 43

44.1. Në lidhje me nenin 54 të ligjit, gjykata vlerësoi se në çdo rast subjektit të rivlerësimit i garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, edhe pse nga kërkuesi nuk ishte dhënë asnjë argument për antikushtetushmërinë e kësaj dispozite. Në vlerësimin e gjykatës, dëshmia e dhënë nga bashkëpunëtori i drejtësisë, sipas nenit 54 të ligjit, do të konsiderohet provë vetëm nëse do të merret nga organet kushtetuese të ngarkuara për këtë qëllim. Edhe për sa i takon nenit 56, pika 1, të këtij ligji, kjo dispozitë është vlerësuar si kushtetuese për sa kohë që nuk i mohon subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dorëhequr, e drejtë që i garantohet atij nga neni G i Aneksit të Kushtetutës. Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet, brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Vlerësimi i Kolegjit të Apelimit

45. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetencat e institucioneve të ngritura posaçërisht bazohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese”.

46. Në zbatim të dispozitës kushtetuese, neni 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcaktojnë: 1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar.

47. Çështja në shqyrtim, bazuar në përcaktimet e sipërcituara, i përket juridiksionit rishikues të rivlerësimit, të drejtës së ankimit kundër vendimit të Komisionit, kompetencat tokësore dhe lëndore i përkasin Kolegjit të Apelimit.

48. Bazuar në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojë ankim pranë Kolegjit edhe Komisioneri Publik.

49. Rezulton se ankimi i paraqitur nga ana e Komisionerit Publik, mban nënshkrimin e z. Florian Ballhysa dhe është regjistruar në institucionin e Komisionerëve Publikë me nr. 6 Prot., datë 23.03.2018.

50. Dispozitat kushtetuese, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2, dhe përcaktimi ligjor, neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 legjitimojnë si ankues jo vetëm Komisionerët Publikë bashkarisht dhe në nivel institucioni, por edhe individualisht Komisionerin Publik, si organ i Institucionit të Komisionerëve Publikë. Në rastin konkret, vullneti rezulton i shprehur nga Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa, në cilësinë e organit, të legjitimuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për ankim nga vetë Kushtetuta dhe ligji.

51. Ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik mban nr. 6 Prot., datë 23.03.2018, ndërkohë që akti i njoftimit në adresë të Komisionerit Publik është shkresa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 2404 Prot., datë 8.03.2018, e thënë ndryshe në ditën e 15^{te}.

52. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton: “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliemeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”, subjekti ankues legjitimohet në aspektin kohor.

53. Procedura e rivlerësimit para Komisionit është zhvilluar me bazë dokumentesh, procedurë e cila ka shoqëruar edhe marrjen e vendimit. Komisioni ka shqyrtuar çështjen në tërësi me bazë dokumentesh, pasi ka vlerësuar vendimmarrjen “Ndërprerje”, jo vendim në themel për të vijuar sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

54. E drejta për t’u dëgjuar publikisht përfshin në vetvete të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, përveç se kur ka rrethana përjashtimore. Si raste përjashtimore, Kolegji i Apelimit vlerëson edhe rastet e dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit nga procesi i rivlerësimit

kalimtar, duke respektuar parimin e transparencës në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt, të sanksionuar nga neni Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Duke iu referuar nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili referon në “Kodin e procedurave administrative”, neni 89 i të cilit përcakton rastet e mbylljes së procedurës administrative pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar.

55. Paraqitja sipas ligjit e aktit të dorëheqjes, i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme dhe, si e tillë, bën pjesë të rastet përjashtimore, në kushtet kur edhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është dhënë në dorëheqjen e paraqitur. Është detyrë e Komisionit ndërkohë, që të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila nga ana tjetër duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: i) Presidenti i Republikës; ii) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (deri në konstituimin e tij Këshilli i Lartë Gjyqësor); iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (deri në konstituimin e tij Prokurorori i Përgjithshëm), dhe njëkohësisht të bëjë transparent gjithë procesin.

56. Verifikimi i vullnetit të subjektit të rivlerësimit për t’u dorëhequr nga procesi i rivlerësimit kalimtar, është kompetencë por edhe detyrim kushtetues i Komisionit, por edhe i Kolegjit të Apelit, i cili në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, mund të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga Komisioni dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim.

57. Mbi këtë bazë, Kolegji i Apelit çmon se pretendimi i Komisionerit Publik për prishjen e vendimit dhe për t’u marrë në shqyrtim edhe një herë nga Komisioni vjen në kundërshtim me nenin F të Aneksit të Kushtetutës.

58. Në seancën gjyqësore publike, datë 31.05.2018, subjekti i rivlerësimit pasi deklaroi se është njohur me vendimin, ankimin, dosjen dhe procesin në ngarkim të tij, konfirmoi vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar të shprehur në shkresat e dorëheqjes nga statusi i magjistratit dhe nga e drejta për t’u emëruar në nivel apeli.

59. Kolegji i Apelit vlerëson me përparësi zbatimin institutin e dorëheqjes sipas ligjit të rivlerësimit në krahasim me institutin e dorëheqjes sipas ligjit të statusit, ndërkohë që akti i dorëheqjes, i paraqitur rregullisht, përbën shkak për ndërprerjen/përfundimin e procedurës në mënyrë që dispozita kushtetuese të zbatohet e plotë dhe në përputhje me doktrinën kushtetuese.

60. Sistemi i rivlerësimit, i ngritur në nivel kushtetues dhe me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, përbën një juridiksion të posaçëm, misioni i të cilit zbatohet nga institucione të pavarura dhe të paanshme, të pajisura me çdo kompetencë kushtetuese në drejtim të implementimit të këtij misioni.

61. Komisioni dhe Kolegji i Apelit, si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, janë të pajisura me kompetencën për të vlerësuar në substancë kushtet e kalimit me sukses të procesit për subjektet e rivlerësimit që i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* dhe konfirmimin në detyrë, ku përfshihen ndër të tjerë të gjithë gjyqtarët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë,

të gjithë prokurorët, Prokurori i Përgjithshëm, Kryeinspektori dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

62. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë gjithashtu institucione kompetente për të vlerësuar shkaqet e moskalimit me sukses të procesit të rivlerësimit çka, bazuar në nenin 179/b, pika 7 e Kushtetutës, përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.

63. Shkak kushtetues për moskalimin me sukses të procesit të rivlerësimit, përbën edhe instituti i “dorëheqjes”, i sanksionuar nga neni G, me titull “Dorëheqja”, i Aneksit të Kushtetutës. Pika 1 e nenit G shprehimisht sanksionon: “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet”. Dorëheqja, në vetvete, e trajtuar posaçërisht nga Kushtetuta, nuk është shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sikurse nuk përbën shkak për konfirmimin në detyrë dhe, si të tillë, Kushtetuta e ka shoqëruar pandashmërisht edhe me përcaktim negativ të drejtash, siç është ndalimi i ushtrimit të profesionit. Pika 2 e nenit G të Kushtetutës sanksionon: “2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

64. Trupi Gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, brenda kompetecave të njohura, për zgjidhjen e çështjes konkrete, e vlerëson atë në drejtim të vullnetit të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për t’u dorëhequr, në drejtim të kompetencës për të shqyrtuar materialisht dhe proceduralisht këtë vullnet, si dhe të pasojave që e shoqërojnë.

65. Për pjesën që u përket kompetencave të Kolegjit të Apelit, neni F, pika 3 e Kushtetutës përcakton: “3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj”.

66. Në përmbledhje të nenit të sipërcituar, Kushtetuta e autorizon Kolegjin për të korrigjuar çdo gabim procedural të Komisionit dhe njëkohësisht i mohon kompetencën e kthimit për rishqyrtim, pavarësisht shkallës së gabimit procedural të kryer nga ana e Komisionit. Në drejtim të kompetencave korrigjuese, Kolegji i Apelit ka vlerësuar vullnetin e subjektit të rivlerësimit për t’u dorëhequr nga detyra. Në seancën e datës 31.05.2018, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet Avokatit Sokol Hazizaj, në përgjigje të pyetjes së Trupit Gjykues nëse i qëndronte çka i ishte kërkuar KPK-së nga z. Llalla me aktet e administruara, ka pohuar: “Pranoj gjithë çka ka deklaruar subjekti i rivlerësimit pranë KPK”. Ky pohim i avokatit shihet në mënyrë të pazgjdhshme i lidhur me prokurën e posaçme nr. 8263 (A), datë 28.05.2018, të nënshkruar para noterit turk Eyüp Sabri Erdoğan dhe të legalizuar sipas Konventës së Hagës së 5 tetorit 1961 (*Apostille*), me të cilën subjekti i rivlerësimit autorizon Avokatin Sokol Hazizaj të përfaqësojë interesat e tij në këtë proces. Avokati i subjektit të rivlerësimit deklaroi gjatë gjithë procesit se vullneti i subjektit ishte pikërisht ai i dorëheqjes nga e drejta e statusit dhe për t’u

emëruar në nivel apeli, në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit G të Aneksit dhe në zbatim të interpretimit pajtues që i ka bërë Gjykata Kushtetuese nenit 56 të ligjit 84/2016 me vendimin e saj nr. 78, datë 17.12.2017. Në këto kushte, në aspektin material, Kolegji vlerëson se vullneti i subjektit të rivlerësimit për t'u dorëhequr nga detyra është i pavesuar dhe i qartë.

67. Aspektet procedurale të dorëheqjes për një vendimmarrje të drejtë, rregullohen nga neni 56, me titull “Dorëheqja”, të ligjit nr. 84/2018 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: “1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.”. Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga detyra para organit kompetent, që është Presidenti i Republikës. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se janë përmbushur edhe elementet deklarative të formalizimit të kërkesës së paraqitur për t'u dorëhequr nga detyra.

68. Në çdo rast, fakti që nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se u provua vullneti i lirë i subjektit për t'u dorëhequr nga e drejta e statusit të magjistratit dhe për t'u emëruar në nivel apeli, si edhe fakti që dorëheqja e subjektit është paraqitur në përputhje me parashikimet e nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 para Presidentit të Republikës, duke zbatuar në këtë mënyrë të paktën një prej rrugëve procedurale që legjislacioni në fuqi parashikon për të prezantuar këtë vullnet, dhe i gjendur në kushtet e detyrimit kushtetues për t'i dhënë zgjidhje çdo çështjeje që lidhet me procesin e rivlerësimit, duke korrigjuar çdo mangësi procedurale të lejuar nga Komisioni, Kolegji i Apelit çmon se vendimmarrja e Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ka qenë e drejtë dhe duhet konfirmuar.

69. Detyrimin për një vendimmarrje të tillë e shpall parashikimi kushtetues i germës “G” të Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Kolegji i Apelit e gjen me vend të konsiderojë të drejtë këtë disponim të Komisionit për sa i përket ndërprerjes duke konsideruar edhe gjithë rrethanat e faktit dhe të ligjit, të cituara më lart.

70. Në ndryshim nga sa ka vendosur Komisioni dhe në përputhje me pretendimin e Komisionerit Publik, Kolegji i Apelit çmon se në pjesën urdhëruese të vendimit duhet të përfshihet edhe parashikimi i paragrafit 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, i cili sanksionon ndalimin për emërim, i cili duhet të aplikohet në rastin kur subjektet e rivlerësimit dorëhiqen nga detyra dhe procesi i rivlerësimit ndaj tyre ndërpritet. Shprehimisht në shkaqet ankimore, sipas ankimit të paraqitur, Komisioneri Publik parashtron: “28. Në kuadër të analizimit të natyrës së dispozitivit që merr institucioni përkatës i rivlerësimit në rastet e paraqitjes së dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, jemi të mendimit se Kolegji i Posaçëm i Apelit, edhe në rastin konkret, duhet të marrë në analizë e të shprehet ndalimi i subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar për 15 vite në sistemin e drejtësisë, sipas pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

71. Ky parashikim i përmendur në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit, në vlerësimin e Kolegjit të Apelit duhet të përfshihet në pjesën urdhëruese të tij, pikërisht për zbatimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të normës kushtetuese.

72. Për sa më sipër, një vendimmarrje e pajisur me këto elemente, heq çdo mundësi për keqinterpretime apo abuzime me të drejtën apo ndalimin e subjektit të rivlerësimit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për periudhën 15-vjeçare dhe i jep një zgjidhje përfundimtare dhe të plotë çdo pretendimi, qoftë të subjektit të rivlerësimit në të nesërmen, si edhe garanton mbrojtjen e interesit të publikut të sanksionuar në Kushtetutë, për të mos lejuar kthimin e kësaj kategorie subjektësh në sistemin e drejtësisë për periudhën e përcaktuar në Aneksin e Kushtetutës.

73. Raporti midis ligjit të rivlerësimit dhe ligjit të statusit rregullohet nga vetë ligji i statusit, neni 164 (“Dispozitat kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”), i cili përcakton se: 1) Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: [...] b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

74. Në përcaktimin e këtij neni, ligjvënësi ka zbatuar parimin e përparësisë në zbatim të ligjit të posaçëm nga organet e posaçme, dhe jo kushtëzimin e veprimtarisë së këtyre organeve nga organet e juridiksionit të përgjithshëm.

75. Nga ana tjetër Kushtetuta, neni 148/c, pika 2, shprehimisht përcakton: “2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. E thënë ndryshe, mungesa e miratimit të aktit “deklarativ” nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në kushtet edhe të moskonstituimit ende të këtij organi, nuk ka kushtëzuar miratimin e aktit krijues të Kuvendit për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm, sipas kompetencave të sanksionuara nga neni 148/a, pika 1.

76. Në kundërshtim me sa Komisionieri Publik pretendon, për vlerësimin e aspekteve formale të dorëheqjes, organet e rivlerësimit janë të pajisura me kompetenca hetimore dhe vendimmarrëse brenda procesit të rivlerësimit, duke përfshirë edhe rastet e dorëheqjes.

77. Duke cituar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017: “43). Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

78. Në kuptim të sa më sipër, instituti i dorëheqjes nga detyra dhe pasoja e ushtrimit të kësaj të drejte në kuptimin material përcaktohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta, neni G, pikat 1 dhe 2, ndërkohë që aspektet e tjera procedurale përcaktohen nga neni 56, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare në internet të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

79. Në kuptimin material, ushtrimi i dorëheqjes nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit përbën shkak ligjor për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, por me kufizimin për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. E thënë ndryshe, ushtrimi i dorëheqjes nga detyra shoqërohet edhe me kufizime të drejtash, sipas nenit 6 të “Konventës evropiane të të drejtave të njeriut”.

80. Dorëheqja nga detyra në kuptim të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, përveç të drejtave dhe detyrimeve të tjera që rrjedhin nga statusi i magjistratit, përjashton mundësinë e emërimit magjistrat dhe atë të caktimit në pozicion, të cilat janë procese të ndryshme sipas ligjit nr. 96/2016.

81. Kompetencat e organeve të rivlerësimit përfshijnë elementin e emërimit të magjistratit subjekt rivlerësimi, sipas nenit 179/b, pika 7 e Kushtetutës që është një prej elementeve të statusit të magjistratëve sipas nenit 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016. Në lidhje me nenin 164, pika 1, gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit. Statusi i magjistratit është një nocion që rezulton nga neni 1 i ligjit nr. 96/2016, i cili në sintezë përcakton se statusi gëzohet ligjërisht nga një person që emërohet në funksion, përfundon me mbarimin e statusit dhe përfshin të drejtat dhe detyrimet e magjistratit, pranimin dhe emërimin e tyre, vlerësimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, si dhe përgjegjësitë disiplinore, penale dhe civile.

82. Në kuptimin procedural, bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016, për të përfituar nga kjo e drejtë, kërkesa e dorëheqjes i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës, kërkesë e cila publikohet në faqen zyrtare në internet të këtij institucioni. Në faqen zyrtare të Presidentit të Republikës (president.al/old), është krijuar një rubrikë e posaçme e titulluar “Publikimet e dorëheqjeve”, sipas nenit 56 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku rezulton se rasti në gjykim mban numrin 12, me datë protokollimi në institucion 12.02.2018.

83. Masat disiplinore të përcaktuara me ligj për procesin e rivlerësimit, në përfundim të procesit, sipas kategorisë së subjekteve të rivlerësimit, mund të ndahen në 3 (tri) grupime: 1. për magjistratët në detyrë, që janë të emëruar dhe të caktuar: a) konfirmimi në detyrë; b) shkarkimi nga detyra; c) pezullimi; 2. për ish-gjyqtarët/prokurorët, që kërkojnë të emërohen dhe të caktohen në detyrë: a) emërimi si gjyqtar ose prokuror; b) refuzimi i emërimit si gjyqtar ose prokuror. Në drejtim të arritjes së qëllimit të saj, vetë Kushtetuta, me bazë prezumimin në favor të masës disiplinore, ka përcaktuar edhe ndalimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

84. Bazuar në këto konsiderata të pranuar nga Kushtetuta dhe të materializuara edhe nga ligji i posaçëm, dorëheqja gjatë procesit të rivlerësimit përbën shkak për ndalim, “kufizimin e të drejtës së emërimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”, prandaj mungesa e përcaktimit në dispozitivin e vendimit mund të përbëjë shkak për pretendimin e mohimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

85. Duke cituar vendimin nr. 27, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese: “14. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës përbën një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të

nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të “Konventës evropiane për të drejtat e njeriut”. Kjo e drejtë e individit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre”.

86. Sipas frymës së GJEDNJ-së, e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë “praktike dhe efektive” dhe që e drejta e aksesit të jetë efektive për individin, ky i fundit “duhet të ketë mundësi praktike për të kundërshtuar një akt i cili përcakton të drejtat e tij”. Në raste të veçanta, natyra praktike dhe efektive e së drejtës së aksesit në gjykatë, mund të cenohet në rastet: i) e aplikimit të pengesave procedurale, ndaluese ose kufizuese të mundësisë për t’iu drejtuar gjykatës; ii) e interpretimit strikt të ligjit kombëtar në lidhje me rregullat procedurale (formalizim i tepruar), që mund të kufizojë kërkuesin nga e drejta e aksesit në gjykatë (pikat 75 e 79 të “Kommentarit mbi nenin 6 të *Konventës për të drejtat e njeriut*”, përditësuar në datën 31 dhjetor nga GJEDNJ-ja). GJEDNJ-ja pranon faktin se garancitë e nenit 6, pika 1 të zbatuara në procedimin bazë për vendosjen e masave disiplinore kundër aplikantit dhe se pezullimi i aplikantit njihsohen me përcaktimin e të njëjtave të drejta civile dhe detyrime dhe se e drejta e aksesit në gjykatë zbatohet edhe për vetë pezullimin (Paluda v. Slovakia). Duke iu referuar çështjes Marušić v. Croatia, paragrafët 74-75, procedimi i cili nuk ndikon drejtpërdrejt në të drejtën e vazhdimit të ushtrimit të profesionit, për shkak se një vendimmarje e tillë do të kërkonte një procedim të veçantë, nuk është përcaktuese për të drejtat civile në kuptim të nenit 6 (pika 9 e “Kommentarit mbi nenin 6 të *Konventës për të drejtat e njeriut*”, përditësuar në datën 31 dhjetor nga GJEDNJ-ja).

87. Subjekti i rivlerësimit është dorëhequr nga detyra pasi nuk ishte më në funksion dhe nga e drejta për caktim në nivel apeli, sipas nenit G, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, prandaj Kolegji i Apelit çmoi të konfirmojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të këtij subjekti, sikurse Komisioni ka vendosur duke ushtruar autoritetin dhe juridiksionin kushtetues edhe për këtë sanksionim.

88. Komisioni nuk është shprehur për këtë përcaktim të drejtash, gjë që e bën të cenueshëm vendimin nr. 2, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe që duhet të ndryshohet me qëllim për t’u garantuar procesi i rregullt ligjor. Është detyrë e Komisionit dhe e Kolegjit të Apelit që të garantojnë zhvillimin e një procesi të rregullt, dhe detyrë e shtuar e funksionit rishikues të Kolegjit të Apelit të korrigjojë gabimet procedurale të Komisionit bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

89. Kolegji i Apelit për të garantuar një mbrojtje efektive, për t’u përgatitur dhe dëgjuar në seancë, në një kohë të arsyeshme ka ruajtur raportin midis të drejtave dhe garancive dhe zhvillimit të procesit në tërësi nëpërmjet dhe vetëm një procesi të rregullt.

90. Këtij subjekti efektivisht nuk i është mohuar e drejta për të ushtruar çdo mjet ligjor në mbrojtje të interesave të tij dhe Kolegji i Apelit gjatë gjithë procesit gjyqësor respektoi dhe garantoi të gjitha procedurat që çojnë në një proces të rregullt ligjor pa i cenuar asnjë të drejtë, madje duke i garantuar të drejtat që parashikon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b. Me procedurat që ndoqi dhe respektoi, i garantoi këtij subjekti elementet e domosdoshme që burojnë nga “Konventa evropiane për të drejtat e njeriut”: i) marrjen dijeni

rregullisht për procesin, njoftimin e vendimit dhe ankimit; ii) lejimin e mbrojtjes dhe përfaqësimit me avokat, të pajisur me dy akte përfaqësimi për të kryer veprime procedurale në drejtim të një vullneti të pavesuar; iii) garantimin e së drejtës së aksesit në gjykatë kundër vendimit dhe ankimit të paraqitur.

91. Me njoftimin rregullisht, me lejimin e pjesëmarrjes në seancë të përfaqësuesit ligjor dhe lejimin e ushtrimit të mjeteve ligjore që ai çmoi në interes të mbrojtjes, Kolegji i Apelit realizoi një proces gjyqësor në përputhje me parimet e kontradiktoritetit të zhvillimit të procesit, aksesit në gjykatë, lejimit të provave në mbrojtje të interesave, sikurse vlerësoi edhe rrethanat e faktit që rezultojnë nga informacioni që këto sillnin si për palën, edhe pr gjykatën.

92. Pretendimet e palës vlerësohen brenda juridiksionit kushtetues, bazuar në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës brenda kuptimit dhe përmbajtjes së ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në analizën juridike të fakteve dhe pasojës juridike të dorëheqjes, ndërprerjes dhe ndalimit kushtetues pas kësaj dorëheqjeje, Kolegji i Apelit i çmoi në këndvështrimin kushtetues dhe i orientuar nga doktrina e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudenca e posaçme e saj, sikurse vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i cili bën interpretimin përfundimtar të nenit 56 dhe korelacionin me nenin G, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës.

93. Kolegjit të Apelit i shërbeu kjo jurisprudencë për të trajtuar në mënyrë të ndërthurur dhe të plotë institutin e dorëheqjes, aktin e ndërprerjes, ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për të konkluduar me pasojën juridike, ndalimin që parashikon neni G kur rrethanat vërtetohen.

94. Gjatë gjykimit u konstatua vullneti i pavesuar i subjektit të rivlerësimit për t’u dorëhequr në formë dhe përmbajtje, duke shkuar më tej vullneti i këtij subjekti edhe me pranimin e vetë pasojës që dispozita kushtetuese sanksionon. Dorëheqja nga detyra sipas sanksionimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është në vetvete heqje dorë nga procesi, nga kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

95. Orientimi i Komisionit për zgjidhje të njëjtë të çështjeve të ngjashme ka qenë pjesë e shkaqeve ankimore të paraqitura nga Komisioneri Publik i cili, ndër të tjera, parashtron se: “31. Jemi të mendimit se për sa kohë në këtë ankim ngrihen shkaqe që lidhen me interpretimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese do t’i shërbente unifikimit të procedurave në të ardhmen në trajtimin e situatave të ngjashme.”

96. Kolegji i Apelit, duke qenë në fillesat e jurisprudencës së tij në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve të kësaj natyre që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu dhe me pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit si pasojë e moskalimit me sukses dhe mosëmërimit në institucionet e drejtësisë të kësaj kategorie subjektsh, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çmon se duhet të orientojë Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme sipas arsytimit dhe konkluzioneve të arritura në këtë vendim.

97. Kolegji i Apelit orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: i) Presidenti i Republikës; ii) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (deri në konstituimin e tij Këshilli i Lartë Gjyqësor); dhe iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (deri në konstituimin e tij Prokurori i Përgjithshëm). Si sanksionim kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, çka është në kompetencën e tij.

PËR KËTO ARSYE

Trupi Gjykues, mbështetur në nenin 66/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

Ndryshimin e vendimit nr. 2, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si më poshtë:

1. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit Adriatik Llalla.
2. Ndalimin e emërimit të z. Adriatik Llalla gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë prej 15 vitesh.
3. Ndaj këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të ushtrojë ankim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në zbatim të nenit F/8 të Aneksit të Kushtetutës.

U shpall në Tiranë, më 11.06.2018.

GJYQTARE

Albana SHFYLLA

GJYQTAR

RELATOR I ÇËSHTJES

Luan DACI

GJYQTAR

Ardian HAJDARI

GJYQTARE

Ina RAMA

GJYQTAR

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES

Sokol ÇOMO

MENDIM PAKICE

1. Ne anëtarët e Trupit Gjykses, të mbetur në pakicë, parashatrojmë mendimin tonë si më poshtë:

2. Pakica ka votuar për prishjen e vendimit nr. 2, datë 16.02.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar "Komisioni") dhe dërgimin e çështjes pranë Komisionit për vazhdimin e procesit të rivlerësimit kalimtar lidhur me subjektin e rivlerësimit Adriatik Xhemal Llalla. Pakica, në ndryshim nga shumica e Trupit Gjykses, vlerëson se ndërprerja e procesit të rivlerësimit nga Komisioni është bërë në zbatim të gabuar të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim referuar "ligji nr. 84/2016"), në shkelje të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe në interpretim të gabuar të nenit G të Aneksit të saj, për shkaqet si vijojnë:

3. Kushtetuta në nenin 179/b, pika 3¹, përcakton shprehimisht natyrën e detyrueshme të procesit të rivlerësimit kalimtar në raport me funksionin e subjekteve të rivlerësimit. Karakteri *ex officio* i këtij procesi nënkupton që, për sa kohë subjekti ushtron funksionin e gjyqtarit ose të prokurorit, duke qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, procesi i rivlerësimit është i detyrueshëm për t'u kryer nga institucionet e rivlerësimit.

4. Të vetmet përcaktime ligjore, të cilat parashikojnë efekte juridike të drejtpërdrejta në lidhje me vijueshmërinë e procesit të rivlerësimit, duke sjellë ndërprerjen apo pushimin e tij, janë përkatësisht neni G i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 56 i ligjit 84/2016.

5. Neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon:

"1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqsor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare."

6. Ndërkohë neni 56 i ligjit 84/2016 parashikon:

"1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se **3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji**. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1 e ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

¹ Neni 179/b, pika 3 parashikon: "Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*".

7. Përmbajtja e nenit G të Aneksit të Kushtetutës i jep të drejtë subjektit të rivlerësimit që, nëpërmjet dorëheqjes nga detyra, të kërkojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, një e drejtë kjo, e cila, sipas arsytimit që ka bërë Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 78, datë 12.12.2017, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi kohor me kushtin që, deri në momentin e ushtrimit nga subjekti i rivlerësimit të kësaj të drejte, procesi i rivlerësimit të mos ketë përfunduar. Ndërkohë, referuar përmbajtjes së pikës 1 të nenit 56 të ligjit 84/2016 del i qartë vullneti i ligjberësit² për kufizimin e fuqisë së zbatimit të këtij neni vetëm për një periudhë të caktuar kohore prej 3 muajsh, duke filluar ky afat nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit. Pakica sjell në vëmendje se ky nen i është nënshtrohet edhe kontrollit për kushtetutshmërinë e tij në raport me nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 ka deklaruar se ky nen është në përputhje me Kushtetutën dhe për asnjë moment nuk e ka vënë në dyshim fuqinë e tij juridike të kufizuar në kohë, në afatin prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka arritur në konkluzionin se subjektet e rivlerësimit, pas plotësimit të afatit të kufizuar kohor të fuqisë së këtij neni, do të vijojnë të gëzojnë të drejtën për t'u dorëhequr, por në këtë rast procesi i rivlerësimit do të ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

8. Afati 3-mujor, i parashikuar në nenin 56, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton të jetë plotësuar në datën 31.03.2017 dhe, për pasojë, pas kësaj date, kjo dispozitë e ka humbur fuqinë e saj juridike. Në këtë kuptim, asnjë dorëheqje e dhënë nga subjektet e rivlerësimit pas kësaj date nuk mund të bazohet në këtë nen dhe, gjithashtu, as institucionet e rivlerësimit, Komisioni apo Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim referuar "Kolegji") nuk mund t'i japin këtij neni fuqi juridike për efekt të shqyrtimit të dorëheqjeve të dhëna pas datës 31.03.2017.

9. Si konkluzion i sa më sipër, pas datës 31.03.2017, e vetmja rrugë ligjore për mënyrën e zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës në rastin e dhënies së dorëheqjes nga detyra të magjistratit, mbetet rregullimi përkatës ligjor i parashikuar nga ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim referuar "ligji nr. 96/2016"), për arsye se vetëm mbarimi i ushtrimit të funksionit të gjyqtarit ose prokurorit sjell si pasojë përjashtimin e subjektit nga rrethi i subjekteve të cilët i nënshtrohen në mënyrë të detyrueshme, *ex officio*, procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Duke qenë se procesi i rivlerësimit zhvillohet *ex officio* për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, asnjë subjekti të rivlerësimit nuk mund t'i ndërpritet procesi i rivlerësimit, për sa kohë ai vazhdon të ruajë statusin e magjistratit. Në kuptim të këtij arsytimi, tagrat që u jep Kushtetuta institucioneve të rivlerësimit për të ndërprerë procesin e rivlerësimit sipas nenit G të Kushtetutës, duhet të ushtrohen në përputhje me frymën e dispozitës kushtetuese të nenit 179/b dhe, për rrjedhojë, procesi i rivlerësimit mund të ndërpritet (në mënyrë të vlefshme) vetëm atëherë kur provohet që akti i vullnetit të subjektit të

² Ky vullnet i ligjberësit është deklaruar nga Kuvendi edhe para Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të kërkesës së Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë dhe Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, për shfuqizimin, ndër të tjera edhe të nenit 56, pika 1 të ligjit 84/2016 si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kuvendi, në cilësinë e subjektit të interesuar në çështjen për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese lidhur me dispozitën në fjalë ka prapësuar: "Për sa i përket nenit 56, pika 1, qëllimi i ligjvënësit është t'i japë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u larguar nga sistemi me dëshirë, pa i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, duke përfutuar edhe një pagesë kalimtare. "Dorëheqja e privilegjuar" nuk duhet ngatërruar me dorëheqjen që çdo subjekt rivlerësimi mund të japë në çdo kohë gjatë procesit të rivlerësimit. [...]"

rivlerësimit për t'u dorëhequr, ka arritur të prodhojë pasojat juridike të mbarimit të statusit të magjistratit (këputjen e lidhjes që ekziston midis subjektit të rivlerësimit dhe sistemit të drejtësisë).

10. Procesi i rivlerësimit ndërpritet atëherë kur provohet që subjekti nuk është më pjesë e sistemit të drejtësisë dhe jo anasjellas, çka në rastin e magjistratit kërkon ndjekjen e procedurës së parashikuar nga neni 65³ i ligjit nr. 96/2016 për mbarimin e statusit të magjistratit.

11. Në çështjen objekt shqyrtimi rezulton se subjekti i rivlerësimit Adriatik Llalla ka paraqitur pranë Presidentit të Republikës, nëpërmjet shërbimit postar, një akt me shkrim të titulluar "Kërkesë Dorëheqjeje", i cili mban datën 10.02.2018 dhe është protokolluar në institucionin e Presidentit të Republikës në datën 12.02.2018. Në përmbajtjen e këtij akti, subjekti i rivlerësimit shpjegon se paraqitjen e dorëheqjes e bën në zbatim të nenit 56 të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe vendimit nr. 79 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese.

12. Rezultoi gjithashtu, e provuar nga gjykimi, se subjekti i rivlerësimit në momentin e dhënies së dorëheqjes gëzonte statusin e magjistratit sipas legjislacionit përkatës në fuqi, për arsye se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, më datë 22.11.2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, për rrjedhojë në kuptim të nenit 2⁴, shkronjave "g" e "gj" dhe nenit 164⁵ të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit gëzonte *ipso jure* statusin e magjistratit, të cilin vazhdonte ta kishte edhe pas përfundimit të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm.

13. Në datën 10.02.2018, kur subjekti Adriatik Llalla ka dhënë dorëheqjen, kishin kaluar më shumë se 10 muaj nga momenti kur neni 56 të ligjit 84/2016 i kishte humbur fuqia juridike. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk mund të jepte dorëheqjen e tij sipas procedurës së parashikuar në një dispozitë e cila e kishte humbur tashmë fuqinë e saj, por duhej të jepte dorëheqjen sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, duke kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit përpara Këshillit përkatës⁶. Gjithashtu, duke qenë se subjekti në bazë të nenit 148/a, pika 5 e Kushtetutës gëzonte të drejtën për t'u caktuar gjyqtar në gjykatën e apelit, do të duhej të hiqte dorë edhe nga kjo e drejtë para organit kompetent dhe, vetëm pasi të kishte ezauruar këto procedura ligjore, subjekti do të kishte shprehur në mënyrë të vlefshme vullnetin e tij për t'u dorëhequr nga detyra, sipas kuptimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

³ Neni 65 i ligjit 96/2016 parashikon: "1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni."

⁴ Në nenin 2, shkronjat "g" dhe "gj" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikojnë shprehimisht:

"g) "Kryetar" i referohet kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, përfshirë Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme.

gj) "Magjistrat" është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës "g" të këtij neni."

⁵ Neni 164 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" parashikon: "1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: a) shfuqizuar, b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". 2. Shfuqizuar."

⁶ Per periudhën transitore, shih nenin 160 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

14. Në përfundim të këtij arsytimi, ndryshe nga qëndrimi i shumicës, sipas të cilit dorëheqja e subjektit është paraqitur në përputhje me parashikimet e nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 para Presidentit të Republikës, duke zbatuar në këtë mënyrë të paktën një prej rrugëve procedurale që legjislacioni në fuqi parashikon për të prezantuar vullnetin e subjektit për t'u dorëhequr nga e drejta e statusit dhe ajo për t'u emëruar në nivel apeli e magjistratit dhe, si pasojë, vendimmarrja e Komisionit ka qenë e drejtë dhe duhet konfirmuar, pakica vlerëson se dorëheqja e subjektit të rivlerësimit Adriatik Llalla është dhënë duke u bazuar në një dispozitë e cila e kishte humbur fuqinë ligjore dhe, si e tillë, nuk ka arritur të prodhojë efektet e pritshme juridike për të mundësuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit G të Aneksit të saj. Për pasojë, vendimmarrja e Komisionit, duke qenë se është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit 84/2016 dhe keqinterpretim i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, duhet prishur.

15. Sa u takon aspekteve procedurale të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në rastin objekt shqyrtimi, ne si pakicë vlerësojmë se moszhvillimi i seancës dëgjimore publike me subjektin e rivlerësimit është në kundërshtim me parashikimin e nenit 55 të ligjit 84/2016. Referuar dispozitës në fjalë, Komisioni fton në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit në përputhje me rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Kjo seancë është publike dhe zhvillohet në përputhje me nenin 20 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar. E drejta e subjektit për t'u dëgjuar, si një ndër elementet e procesit të rregullt në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për ndërprerjen e procesit, si pasojë e kërkesës së dorëheqjes së këtij të fundit, nuk është respektuar nga ana e Komisionit.

16. Vendimmarrja e Komisionit – lidhur me shqyrtimin e kërkesës për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, në kuadër të dorëheqjes së subjektit nga detyra, siç rezulton nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore – është bërë me bazë dokumentesh dhe mosthirrja e subjektit në seancë dëgjimore nuk rezulton të jetë rrjedhojë e një vendimmarrjeje të mbështetur në një urdhërim të caktuar ligjor. Për më tepër, vihet re se Komisioni nuk ka arsyetuar nëse nevojitet apo jo zhvillimi i seancës dëgjimore. Në këtë kuptim, Komisioni do të duhej të kishte marrë në shqyrtim rastet përjashtimore të përcaktuara nga neni 89 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa nevojën e njoftimit të subjektit dhe pa i dhënë mundësinë këtij të fundit për t'u dëgjuar lidhur me kërkesën e tij.

17. Në analizë të rasteve të përcaktuara në mënyrë shteruese nga legjislatori në nenin 89⁷ të Kodit të Procedurave Administrative, arrijmë në këto konkluzione: (i) Nuk jemi në kushtet e parashikuara nga pika "a" e nenit 89, pasi nuk identifikohet nga ana e Komisionit asnjë nevojë urgjence në vendimmarrjen e tij për rastin në fjalë, si pasojë e dëmit që mund t'i shkaktohet

⁷ Neni 89 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon: "Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonësës interesit publik;
- b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative;
- c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës;
- d) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur është parashikuar shprehimisht me ligj."

interesit publik. Për më tepër, për sa kohë procesi i rivlerësimit vijon sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj, kjo i shërben më së miri dhe më së pari interesit publik. (ii) Gjithashtu nuk jemi në kushtet e pikës “b” të nenit 89 pasi, siç rezulton edhe nga materialet e dosjes gjyqësore, subjekti ka depozituar pranë Komisionit vetëm një kërkesë në datën 12.02.2018, por pa paraqitur para trupit gjykues të çështjes mendime, komente apo shpjegime të plota në lidhje me vullnetin e shprehur. Për më tepër, subjektit nuk i është kërkuar nga Komisioni asnjë shpjegim sa i takon përmbajtjes së tekstit të kërkesës së dorëheqjes, pasi ajo nuk bazohej në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, por i referohej vetëm nenit 56 të ligjit 84/2016 (pa fuqi ligjore në atë moment kohor) dhe vendimit nr. 79/2017 të Gjykatës Kushtetuese, i cili nuk ka asnjë lidhje me procesin e rivlerësimit. Duhet theksuar fakti që aktit të dorëheqjes së datës 10.02.2018 dhe kërkesës drejtuar Komisionit të datës 12.02.2018, të depozituara me anë të shërbimit postar, nuk u bashkëlidhej asnjë dokument identifikimi i subjektit nënshkruar (letërnjoftim apo pasaportë, të cilat kanë si elemente të tyre edhe nënshkrimin e mbajtësit) dhe, si pasojë, ishte e pamundur për Komisionin të verifikonte se akti i dorëheqjes ishte hartuar dhe nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit Adriatik Llalla, duke u vënë në dyshim vullneti i tij për të dalë jashtë sistemit të drejtësisë. (iii) Nuk jemi në kushtet e parashikuara shprehimisht nga pika “c” e nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi kërkesës së subjektit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, i atribuohen efekte ligjore negative në raport me të drejtat e tij për karrierë në sistemin e drejtësisë. Fakti që Komisioni në vendimin e tij nr. 2, datë 16.02.2018, nuk vendosi ndalimin e emërimit të subjektit Adriatik Llalla gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë, Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë prej 15 vitesh, si urdhërim i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nuk justifikon zbatimin e pikës “c” të nenit 89 të sipërcituar si vendimmarrje në favor të palës kërkuese. (iv) Gjithashtu, pikat në vijim “ç” dhe “d” të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative janë të pazbatueshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

18. Shumica në arsyetimin e saj⁸ e justifikon moszhvillimin e seancës dëgjimore nga Komisioni duke pranuar se rastet e dorëheqjeve të subjekteve përfshihen në rastet përjashtimore, por nuk e analizon se në cilin parashikim konkret të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative bazohet ky qëndrim.

19. Si konkluzion i sa më sipër, pakica vlerëson se moszhvillimi i seancës dëgjimore publike nga Komisioni gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje nuk ka pasur asnjë bazë ligjore dhe njëkohësisht ka cenuar edhe transparencën e këtij procesi, i cili në themelin e tij ka nevojën e rikthimit të besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

20. Shumica ka vlerësuar se, duke iu referuar pikës 3 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, Kolegjit i mohohet kompetenca e kthimit të çështjes pranë Komisionit për rishqyrtim, pavarësisht shkallës së gabimit procedural të kryer nga ana e këtij të fundit.

⁸ Shih paragrafin 54 të vendimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.06.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

21. Ne si pakicë ndajmë një mendim të ndryshëm me shumicën, e cila nëpërmjet interpretimit të zgjeruar që i ka bërë dispozitës kushtetuese, përveçse tejkalon qëllimin për të cilin është krijuar kjo normë, njëkohësisht krijon kundërshti me dispozitat e tjera kushtetuese që përcaktojnë sferën e kompetencave të organeve të rivlerësimit.

22. Kushtetuta në nenin F, pika 3 e Aneksit të saj, parashikon shprehimisht: “Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.”

23. Interpretimi i nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës duhet bërë në harmoni me pikat 2, 5 dhe 6 të nenit 179/b të Kushtetutës, sipas të cilave parashikohet:

“2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. [...]

6. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë të pavarur dhe të paanshëm.”

24. Rregullimi i mësipërm kushtetues në funksion të garantimit të parimeve të procesit të rregullt, ka bërë një ndarje të plotë dhe të qartë të kompetencave midis Komisionit, si i vetmi institucion që kryen rivlerësimin kalimtar, dhe Kolegjit si organi i vetëm gjyqësor që kryen kontrollin e vendimeve të Komisionit mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit apo Komisionerit Publik, duke garantuar në këtë mënyrë të drejtën themelore të subjekteve të rivlerësimit për akses në gjykatë, në përputhje me nenin 42, paragrafi 2 i Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i “Konventës evropiane për të drejtat e njeriut”.

25. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye, Kolegji nuk mund të bëjë rivlerësimin kalimtar të subjekteve të parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës në rast se ky rivlerësim nuk është kryer fillimisht nga Komisioni. Të pranosh të kundërtën do të thotë që Kolegji të përthithë kompetencat kushtetuese të Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit, duke deformuar rolin e posaçëm të institucioneve të rivlerësimit dhe gjithë procesin e rivlerësimit në tërësi.

26. Zhvlerësimi i rolit kushtetues të Kolegjit, si organi i vetëm gjyqësor me kompetencë kontrollin gjyqësor të vendimeve të Komisionit, në kuadër të garantimit të së drejtës së subjekteve të rivlerësimit për akses në gjykatë, bie ndesh edhe me Opinionin Përfundimtar⁹ të Komisionit të Venecias, i cili thekson nevojën e këtij raporti institucional të Kolegjit ndaj vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur edhe në “Parimet bazë të Organizatës së

⁹ Shih Opinionin Përfundimtar të Komisionit të Venecias “Opinion No. 824/2015, CDL-AD(2016)009” lidhur me projekt-ndryshimet e rishikuara kushtetuese për gjyqësorin në Shqipëri”, paragrafët 62, 63.

Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqësorit” (parimi 20¹⁰), si dhe Rekomandimit CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (paragrafi 48) për gjyqësorin: pavarësi, efikasitet dhe përgjegjësi¹¹.

27. Si konkluzion të sa më sipër, pakica vlerëson se Kolegji nuk mund t’ia kthejë çështjen Komisionit për rishqyrtim sipas fjalisë së dytë, të pikës 3, të nenit F të Aneksit të Kushtetutës në rastet kur kontrollon një vendim përfundimtar të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit, por ky rregullim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur Komisioni ka vendosur pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Në këtë rast Kolegji – nëse në përfundim të gjykimit të ankimit, e gjen vendimin e Komisionit për pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të pabazuar në ligj – ka të drejtë ta prishë atë dhe të urdhërojë Komisionin të vazhdojë procesin e rivlerësimit për subjektin përkatës, pasi ai vetë, për arsyet e trajtuara më sipër, nuk mund të kryejë rivlerësimin fillestar të subjektit. Kjo situatë procedurale nuk duhet ngatërruar me “kthimin për rigjykim”, për sa kohë Komisioni nuk ka gjykuar në themel për rivlerësimin e subjektit.

28. Në rastin objekt shqyrtimi, Komisioni me anë të vendimit nr. 2, datë 16.02.2018, nuk ka kryer rivlerësimin kalimtar të subjektit Adriatik Llalla, por vetëm ka deklaruar ndërprerjen e këtij procesi. Bazuar në analizën e mësipërme, në kushtet kur gjykimi provoi se ndërprerja e procesit të rivlerësimit nuk është bërë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, pakica mendon se zgjidhja e drejtë e çështjes objekt shqyrtimi, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit 84/2016, duhet të ishte:

Prishja e vendimit nr. 2 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 16.02.2018, dhe dërgimi i çështjes pranë Komisionit për vazhdimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin Adriatik Llalla.

Tiranë, më 11.06.2018

GJYQTARE


Albana SHTYLLA



GJYQTAR

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES

Sokol ÇOMO



¹⁰ Parimi 20 parashikon shprehimisht: “Procedurat e vendimeve disiplinore, pezullimi apo largimi, duhet të bëhen me anë të një rishqyrtimi të pavarur. Ky parim mund të mos zbatohet në vendimet e gjykatës më të lartë dhe ato të legjislaturës në gjykime apo procedura të ngjashme.”

¹¹ Paragrafi 48 i Rekomandimit CM/Rec(2010)12 i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, më 17.11.2010, parashikon: “kandidati duhet të ketë të drejtë të kundërshtojë vendimin ose të paktën procedurën sipas së cilës është marrë vendimi”.